




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vucitrn – Municipality of Vushtrri



Drejtoria e Arsimit

10 Nr. 731 /24

Datë: 09.07.2024

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013 “Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës” dhe bazuar në Kushtet dhe kriteret për regjistrim të nxënësve në klasën e (10) në Gjimnaze dhe Institucionet e Arsimit dhe aftësimit Profesional të shpallura nga MASHT, nr. 1400/22 dt.22.06.2022:

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT NË VUSHTRRI SHPALL

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË GJIMNAZ DHE NË SHKOLLAT TEKNIKE DHE PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2024/25

Planifikimi për regjistrim të nxënësve në klasën e dhjetë (X) për Gjimnazin në Vushtrri:

SHKOLLA	Drejtimi	Nr. i Paraleleve	Nr. Nxënësve në një paralele	Gjithsej për drejtim
Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri	Natyror	6	24	144
	Shoqëroro – Gjuhësor	5	24	120
Gjithsej:		11		264

**Planifikimi për regjistrim të nxënësve në klasën e dhjetë (X) për shkolla Teknike dhe
Profesionale- Vushtrri**

Shkolla	Drejtimi	Profili	Nr.i paral.	Nr.i nxën.
SHMT" Lutfi Musiqi" Shkolla	Makineri	Zdruktitari/dual	1	24
		Dirigjimi kompjuterik i makinave	1	24
		Automekanik/dual	1	24
		Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujesjellesit	1	24
		Trafik rrugor	1	24
	Elektroteknik, Teknologji e informacionit dhe komunikimit	Zhvillues i aplikacioneve	2	48
		Teknik i informatikës së biznesit	1	24
		Mekatronikë	1	24
		Teknik e elektronikës	1	24
		Instalues elektrik	1	24
SHMT" Lutfi Musiqi" Vushtrri	Gjithsej:	11	264	
SH.M.P " Bahri Haxha" Vushtrri	Agrokulturë, pylltari, peshkatari dhe veterinar	Agrobiznes	2	48
		Hortikulturë	1	24
		Përpunues i ushqimit dhe profesione të ngjajshme	1	24
	Makineri, prodhim dhe ndërtimtari	Arkitekturë	1	24
		Laborant i kimisë	1	24
		Përpunimi i metaleve	1	24
	Ekonomi, administrim dhe juridik	Marketing	1	24
		Shpedicion dhe Logjistikë	1	24
		Tregtar me shumicë dhe pakicë	1	24
	Shërbime	Kuzhinjer	1	24
	Art	Konfeksion	1	24
SHMP" Bahri Haxha" Vushtrri	Gjithsej:	12	288	

Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente: - Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron) - Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe - Certifikatën e lindjes.

Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2024/2025, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e nëntë (IX) jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

Konkursin dhe kriteret e detajuara për secilin drejtim i gjeni të publikuara në shkollat përkatëse dhe në web faqen e Komunës së Vushtrrisë; <https://kk.rks-gov.net/vushtrri/>

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

- Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2024/2025, bëhet më datë : **10, 11, dhe 12 korrik 2024** duke filluar nga ora 8:00-16:00.
- Shpallja e rezultateve më **13.07.2024**
- Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet me 15.07.2024 duke filluar nga ora 8:00-16:00.

AFATI I ANKESAVE

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejt, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës.

Vërejtje: Mos shfrytëzimi i ankesës në afatin zyrtar, në shkollën përkatëse, nënkupton humbje e të drejtës për ankesë në shkallën e dytë në Drejtorinë e Arsimit (DKA) apo në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). DKA dhe MASHT nuk shqyrton asnjë ankesë nëse ajo paraprakisht nuk është shqyrtuar nga komisioni përkatës i shkollës.



Albanez Tahiraj

Drejtori i DKA-së